



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 345 Regj.Themeltar

Nr. 201 vendimi

Dt. 22.08.2019

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë nga:

Kryesuese: Alkelina Gazidedja
Anëtar : Amarildo Laçi
Anëtar : Bari Shyti

Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Kristina Përnaska**, sot më dt. **22.08.2019** mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen administrative me palë:

PADITËS: **Zhaklina Peto**, e bija e Vladimir-it dhe e Shefikat, e dtl 18.09.1972, lindur dhe banuese në Tiranë me adresë Rezidenca “Kodra e Diellit” ap 77, përfaqësuar në gjykim nga av.Illir Dode me prokurë të posaçme nr.1774 rep e nr.477 kol datë 14.08.2019,

I PADITUR: **Këshilli i Emërimeve në Drejtësi**, me adresë Rr “Ibrahim Rugova” ndërtesa nr.20, 1001 Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga Laureta Nezaj, këshilltare e Gjykatës së Lartë dhe pranë KED-së me autorizimin e lëshuar nga Kryetari i KED-së me nr.494 Prot datë 13.08.2019.

PERSON I TRETË: **Avokati i Popullit**, me adresë Rr “Vllazen Huta” Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga znj.Erinda Ballanca.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me adresë Blv “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, përfaqësuar nga z.Bledar Dervishaj me autorizim nr.2861 prot datë 14.08.2019.

OBJEKTI: Shfuqizimin e vendimit nr. 108 datë 02.08.2019. Ndalimin e kandidimit te kandidatës Zhaklina Peto në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese vakancë e parakohshme shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018. Lejimin e kandidimit të Zhaklina Peto për vakancën e parakohshme shpallur në datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.

Shfuqizimi i vendimit nr. 109, datë 02.08.2019. Ndalimin e kandidimit të kandidatës Zhaklina Peto në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018. Lejimin e kandidimit të Zhaklina Peto për vakancën e parakohshme shpallur në dt 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e RSH neni 149/d. Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” neni 226-238 e vijies. Vendimi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligji nr. 49/2012 “Për gjykatën administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Gjykata pasi mori në shqyrtim provat shkresore, dëgjoi dhe pretendimet përfundimtare të palëve, të cilat kërkuan:

Paditesja Zhaklina Peto, kërkoi: Pranimin e padisë, Shfuqizimin e vendimit nr. 108 datë 02.08.2019, nr. 109, datë 02.08.2019 të palës së paditur KED-së, në lidhje me pikën e dytë të padisë për “Lejimin e kandidimit” në çmim të Gjykatës.

Pala e paditur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kërkoi: Rrëzimin e plotë të kërkesë padisë.

Avokati i Popullit, kërkoi: Pranimin e kërkesë padisë për pikën e parë dhe rrëzimin e padisë për pikën e dytë.

Presidenti i Republikës së Shqipërisë kërkoi: Pranimin e padisë për pikën e parë të objektit të padisë, sa i takon “*lejimit të kandidimit*” në çmim të Gjykatës.

VËREN

Rezulton se paditësja Zhaklina Peto ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Apelit në datë 09.08.2019, e cila është regjistruar me nr. 345 regjistri me palë të sipër cituara dhe objekt: “Shfuqizimin e vendimit nr. 108 datë 02.08.2019. Ndalimin e kandidimit te kandidatës Zhaklina Peto në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese vakancë e parakohshme shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018. Lejimin e kandidimit të Zhaklina Peto për vakancën e parakohshme shpallur në datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës”.

Gjithashtu rezulton se paditësja Zhaklina Peto ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Apelit në datë 13.08.2019, e cila është regjistruar me nr. 347 regjistri me palë të sipër cituara dhe objekt: “Shfuqizimin e vendimit nr. 109 datë 02.08.2019. Ndalimin e kandidimit te kandidatës Zhaklina Peto në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018. Lejimin e kandidimit të Zhaklina Peto për vakancën e shpallur në datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës”.

Në lidhje me kërkesë padinë e dytë (çështja me nr.347 Regj Them, datë 13.08.2019) të paraqitur nga pala paditëse Zhaklina Peto në datën 13.08.2019 në sekretarinë e Gjykatës, Gjykata Administrative e Apelit, e përbërë nga KS, EM dhe BK, me vendimin e ndërmjetëm të datës 20.08.2019 kanë vendosur: *“1.Të urdhërojë bashkimin e çështjes me nr.regjistri themeltar 347 datë regjistrimi 13.08.2019 që i përket palëve: paditës: Zhaklina Peto, i paditur K.E.D, palë e tretë: Presidenti i Republikës, Avokati i Popullit, me objekt:”Shfuqizimin e vendimit nr.109 datë 02.08.2019 të KED-së dhe lejimin e kandidimit” me çështjen nr.345 regjistri themeltar datë 09.08.2019 që u përket palëve: paditës: Zhaklina Peto, i paditur KED, person i tretë: Presidenti i Republikës, Avokati i Popullit, me objekt: “Shfuqizimin e vendimit nr.108 datë 02.08.2019 të KED-së dhe lejimin e kandidimit”. 2.Dërgimin e akteve të çështjes për vazhdimin e gjykimit trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Apelit që ka në gjykim çështjen me nr.345 Regjistri Themeltar datë 09.08.2019 e cila është regjistruar më parë”, ky vendim është bazuar në nenin 24 të ligjit nr. 49/2012“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Në këto kushte dy çështjet u gjykuan nga një trup gjykues, në një gjykim të vetëm.*

Rrethanat e faktit

Është pranuar dhe rezulton në gjykim se paditësja Zhaklina Peto ka shprehur interesin dhe ka aplikuar në 2 vakancat (vakancë e parakohshme dhe vend vakat) të shpallura nga Presidenti i Republikës në 07.02.2018 për anëtare e Gjykatës Kushtetuese.

Për secilën kërkesë të paraqitur nga paditësja është hedhur shorti për caktimin e relatorit të çështjes sipas parashikimeve të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 dhe pikave 5, 27 - 37 dhe 41 të Vendimit nr. 2 datë 15.02.2019, dhe për paditësen janë përcaktuar relatorët, Eriol Roshi dhe Arta Marku.

Sipas pikës 22 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” paditësja është njoftuar nëpërmjet postës elektronike (e-mail) në adresën e deklaruar për tu paraqitur pranë KED, për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës së saj.

Në datën 15.04.2019 është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësoheshin për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj. Në datën 16.04.2019 ka depozituar në sekretarinë e KED formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit.

Më tej ka nisur procedura për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 265 prot, datë 19.04.2019, KED, i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjorë të kandidimit sipas ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” dhe ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe deklarata e nënshkruar nga kandidatja Zhaklina Peto, ku evidentohet se është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjorë të kandidatës për procedurën e verifikimit të kandidaturës.

Me shkresën nr. 2854/4 prot, datë 03.05.2019, ILDKPKI ka informuar KED se kandidatja Zhaklina Peto e ka përmbushur detyrimin e përcaktuar nga pika 2 e nenit 235 të ligjit nr. 115/2016 për të dorëzuar të plotësuar pranë atij institucioni Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë.

ILDKPKI, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të ligjit nr. 9049/2003 dhe ligjit nr.9367/2005, me shkresën nr. 17/28 prot, datë 30.05.2019, ka dërguar pranë të paditurit Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidaten Zhaklina Peto dhe personat e lidhur me të.

Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i padituri KED ka kryer veprimet verifikuese të kërkimit nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatës paditëses Zhaklina Peto dhe personave të lidhur me të.

ILDKPKI në raportin e paraqitur ka ardhur në përfundimet se:

- a) *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*

- b) *Ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e pasurive;*
- c) *Ka mosdeklarime të pasurive dhe vlerave të tyre;*
- ç) *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- d) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*
- e)

Në lidhje me përfundimet e raportit të ILDKPKI-së, i padituri KED ka njoftuar palën paditëse me e-mailin e datës 30.05.2019, për të dhënë shpjegimet përkatëse mbi këto gjetje si dhe për mundësinë për depozitim të çdo dokumenti justifikues që paditësja mund të dispononte. Me shkresën e datës 06.06.2019, nr. 380 prot të KED, pala paditëse ka dhënë shpjegimet përkatëse dhe ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues për të gjitha gjetjet e ILDKPKI-së.

Në rrugë elektronike (e-mail) të datës 25.07.2019 pala paditëse është njoftuar se në mbledhjen e datës 24.07.2019 KED, ka vendosur të caktojë ekspertin kontabël të autorizuar dhe auditues ligjor, z.Arqile Mishtaku për të marrë nga ai mendimin e specializuar lidhur me disa të dhëna dhe çështje që kanë rezultuar nga kontrolli pasuror dhe përfundimet e arritura nga ILDKPKI, si edhe nga shpjegimet dhe dokumentacioni shtesë i paraqitur përpara të paditurit KED nga pala paditëse Zhaklina Peto.

Në rrugë elektronike, në datën 25.07.2019 paditësja ka njoftuar se nuk ka konflikt interesi dhe asnjë shkak papajtueshmërie me ekspertin e caktuar.

Në datën 29.07.2019, eksperti Arqile Mishtaku ka depozituar në zyrën e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi materialin që përmban mendimin me shkrim lidhur me detyrat e ekspertimit të caktuara nga KED.

Në datën 01.08.2019 pala paditëse është njoftuar nëpërmjet postës elektronike (e-mail) dhe është njohur me mendimin me shkrim të ekspertit, nuk ka shprehur kundërshti dhe ka qënë dakort për gjetjet dhe përfundimet përkatëse.

Në përfundim të analizës së hollësishme financiare bazuar në të gjithë dokumentacionin e administruar, në përgjigje të detyrave eksperti, ka ardhur në përfundimet si më poshtë:

“Pasuritë e krijuara në vitet 1996 -2019 janë plotësisht të justifikuar nga të ardhura të ligjshme të familjes të znj.Zhaklina Peto dhe personat e lidhur me të , vlera totale e tyre është 55.68 % e të ardhurave familjare të krijuar në këto vite.

Në aktin e ekspertizës të ILDKPI , të ardhurat që znj Zhaklina Peto ka përfituar nga mbi ngarkesa orare në vite dhe pagat e përfituar nuk janë të llogaritur drejtë , ne kemi mbledhur të gjitha kreditimet në dokumentit “Statement of Account” të BKT, Raiffesien Bank, Prokredit Bankë, Credins Bankë dhe Bankës Popullore të cilat janë në raportin e ILDKPI në faqen 96 deri në faqen 443 .

Të ardhurat nga z.Aurel Vula në vite të cilat ne i kemi llogaritur nga lëvizjet në dokumentin "Statement of Account" Banka ProCredit Nr llog103590280001 në shumën prej 4,420,253.00 leke ,

Shuma e të ardhurave që janë llogaritur në Akti i ekspertizës nga ana e ILDKPKI (faqe 39 e raportit , Faqe 1531 e dosjes) janë si më poshtë :

- Për znj Zhaklina Peto shuma e vlerësuar nga ILDKPKI është 29.000.000 lekë , kurse ne i kemi llogaritur në vlerën prej 35.254.386 diferenca është + 6.25.386 lekë (fq 39 raportit të ILDKPKI)
- Për z.Aurel Vula shuma e vlerësuar nga ILDKPKI është 15.000.000 lekë , kurse ne i kemi llogaritur në vlerën prej 20.148.900 diferenca është +5.148.900 leke (fq 39 raportit të ILDKPKI)
- Shpenzimet jetike të vlerësuar nga ana e ILDKPKI është 12.000.000 lekë , kurse bazuar normave të konsumit të INSTAT-it për vitet 1996 deri në 03/2019 i kemi llogaritur në vlerën prej 11.372.000 diferenca është 628.000 lekë (fq 40 raportit të ILDKPKI) ”.

Në datën 02.08.2019 KED ka mbajtur mbledhjen me rend dite: Shqyrtimi i rasteve për gjetjet e deritanishme, në procedurën e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese, znj.Zhaklina Peto.

Me vendimin nr. 108 datë 02.08.2019 i padituri KED ka vendosur: Ndalimin e kandidimit të kandidates Zhaklina Peto në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese vakancë e parakohëshme të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

Me vendimin nr. 109 datë 02.08.2019 i padituri KED ka vendosur: Ndalimin e kandidimit të kandidates Zhaklina Peto në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018.

Pala e paditur KED në zbatim të ligjit ka njoftuar palën paditëse për vendimet e marra prej saj. Paditësja pasi është njohur me vendimet e marra nga i padituri KED dhe duke mos qenë dakort me vendimin, i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Apelit në datë 09.08.2019 dhe 13.08.2019, padi të cilat sikundër u citua më sipër janë bashkuar dhe u gjykuan në një gjykim të vetëm.

Pretendimet e palëve

Pala paditëse kërkoi pranimin e padisë shfuqizimin e vendimeve nr. 108 datë 02.08.2019, nr. 109 datë 02.08.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, ndërsa për pikën e dytë të padisë e la në çmim të gjykatës, duke pretenduar se:

Së pari: Nga ana e Këshillit është shkelur pika 34, gërma B, Kreu III, "Fazat e procedurës administrative të verifikimit të kandidatëve e vendimit Nr. 4, datë 11.03.2019 "Për Procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të

lartë të Drejtësisë”i cili parashikon: “Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i njoftohet kandidatit të verifikuar dhe subjekteve që ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit sipas ligjit. Avokatit të Popullit i dërgohet edhe dokumentacioni i përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera prej tij gjatë procedurës së ndjekur për verifikimin e kandidatit. Ky njoftim bëhet publik edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi”.

Rezulton që seanca e datës 02.08.2019, nga i padituri KED është zhvilluar në shkelje të rënda të procedurës të cilat ky Këshill ka për detyrë ti zbatojë në mënyrë rigoroze, në bazë të nenit 229/2 të ligjit nr.115/2016 dhe të vendimit Nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në gjykatën kushtetuese dhe të inspektorit të lartë të drejtësisë”, të miratuar nga vetë i padituri KED.

Paditësja Zhaklina Peto nuk është njoftuar dhe për rrjedhojë nuk është njohur me relacionin e përgatitur nga relatorët në përfundim të hetimit administrativ që ata kanë kryer për shqyrtimin e kriterëve ligjore, profesionale dhe morale.

Mosnjoftimi i relacionit të kryer nga relatorët e çështjes përbën një shkelje të rëndë të procedurës së verifikimit pasi paditëses nuk i është dhënë mundësia të njihet me përfundimet të cilat do ti relatoheshin KED, Avokatit të Popullit dhe subjekteve që ftohen të marrin pjesë në këtë proces (*parashikimi i nenit 233 të ligjit nr. 115/2016*).

Mosnjohja me relacionin e relatorit, ditën dhe orën e zhvillimit të mbledhjes ka cënuar rëndë procesin administrativ të verifikimit të kandidaturës time për pozicionin vakant në Gjykatën Kushtetuese, duke çuar në një vendimarrje të gabuar të KED.

Me veprimet e tij i padituri KED ka mohuar të drejtat: Për tu shprehur në lidhje me gjetjet faktet dhe provat sipas parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr.44/2015. “*Të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për faktet, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes*”.

Të drejtën për tu informuar gjatë procesit të hetimit administrativ (konkretisht relacionit të hartuar nga relatori i çështjes, datën dhe orën e mbledhjes).

Parimi i transparencës, në lidhje me gjetjet dhe konkluzionet gjatë procedurës së verifikimit, parimi i drejtësisë dhe i paanësisë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie. Në rastin e palës paditëse ky parim nuk është zbatuar pasi nga i padituri KED, kjo procedure është bërë për kandidatët e tjerë konkures ndërsa për paditësen jo. Duke mbajtur kështu 2-standarte.

Parimi i objektivitetit, relatori ka përgatitur një relacion dukshëm në mungesë të pasqyrimin të saktë të provave të dorëzuara nga paditësja Zhaklina Peto, duke iu referuar mungesës totale të evidentimit të provave në lidhje me kriterin e pasurisë të cilat do ti jepnin një qasje tjetër relacionit duke e bërë atë më konkret me qëllim që të ishte lehtësisht i kuptueshëm për analizën e gjetjeve të pasurisë.

Nëse paditësja do të ishte njohur me përmbajtjen e relacionit të hartuar nga relatori i çështjes, do të ushtronte të drejtën për një proces të rregullt administrativ të procedurës së verifikimit të kriterit të pasurisë duke i mohuar kështu të drejtën për tu shprehur kryesisht sipas parashikimit në gjurmën B,

Kreu II Rregullat të përgjithshme të procedurës së verifikimit, pika 6 dhe 7 e vendimit Nr. 4, datë 11.03.2019, ku parashikohet se:

6. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së verifikimit, me kërkesën e tij, të njihet me dokumentet e dosjes së kandidimit dhe aktet procedurale të kryera nga relatori dhe Këshilli për verifikimin e kandidaturës, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative dhe atyre të përcaktuara në këtë Vendim.

7. Kryesisht apo mbi kërkesën e Këshillit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore të lidhura me kandidimin e tij/saj, si dhe të depozitojë dokumente shkresore shtesë, në mbështetje të këtyre shpjegimeve.

Në këtë mënyrë dukshëm evidentohet mohimi i së drejtës për të dhënë shpjegime me shkrim shtesë për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore të lidhura me kandidimin e palës paditëse pasi të njihesha me relacionin dhe gjetjet e tij.

Së dyti: Vendimi nr 108, 109 datë 02.08.2019 “Për ndalimin e kandidimit tim për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese”, është i pa arsyetuar dhe në mungesë të plotë të pasqyrimin të fakteve, rrethanave, provave detyrim që rrjedh nga neni 100 i ligjit nr 44/2012 dhe neni 235 pika 4 e ligjit 115/2016.

Nga analiza e vendimit objekt gjykimi dukshëm konstatohet:

- i. Mospasqyrimi i provave të marra në shqyrtim nga KED.
- ii. Mungon analiza e provës në veçanti dhe analiza e tyre në përgjithësi.
- iii. Mungon vlerësimi i provave dhe lidhja e tyre me konkluzionin.

Përfundimi i nxjerrë nga KED se deklarimi i bërë nga kandidatja nuk është e saktë në përputhje me ligjin ka mungesë dokumentacioni si dhe mungesë të deklarimeve të pasurive dhe vlerave të tyre është një konkluzion i pa mbështetur në analizën e provave dhe ligjit çka sjell për pasojë pavlefshmërinë e këtij vendimi.

Arsyetimi i vendimit në rastin konkret mbart një detyrim të shtuar ligjor për shkak të zbatimit të parimit të diskrecionit dhe parimit të proporcionalitetit, pasur në vëmendje faktin që vendimet e KED në rastin konkret kundërshtohen në Gjykatën Administrative të Apelit vetëm për shkelje të procedurës. Mungesa e arsytimit të vendimit të KED-së sipas ligjit e bën atë një akt absolutisht të pa vlefshëm.

Së treti: Përsa i përket aktit të ekspertimit, sikundër rezulton nga procedura e ndjekur nga i padituri KED në rastin tim është proceduar me marrjen e një vendimi të specializuar një eksperti kontabel Arqile Mishtaku. Në procedurën e caktimit të ekspertit paditësja është njoftuar nga Këshilli me e-mail për emrin e ekspertit dhe është pyetur nëse ka shkaqe papajtueshmërie, pasi është kryer akti i ekspertimit i është komunikuar rezultati i tij. Në asnjë moment nga i padituri nuk ka njoftuar vendimin e ndërmjetëm të caktimit të pyetjeve të ekspertit, duke me mohuar mundësinë për të parashtruar pyetje ekspertit. Akti i ekspertimit është njoftuar me e-mail në datë 01.08.2019.

Së katërti: KED ka shkelur pikën 74 gërma A Kreu IV “Procedura të veçanta për verifikimin e kandidatëve” i cili parashikon: Kur e vlerëson, Këshilli mund të thërrasë ekspertin për të dhënë shpjegime në mbledhjen e Këshillit. Në vendimin e arsyetuar të Këshillit për lejimin ose ndalimin e kandidimit trajtohet edhe nevoja për ekspertim dhe mendimi i dhënë nga eksperti”.

Në rastin konkret eksperti nuk rezulton të jetë paraqitur në Këshill dhe të japë mendime në lidhje me aktin e kryer prej tij si dhe në vendimin nr.108, 109 datë 02.08.2019, nuk gjen arsyetim fakti përse mendimi i dhënë nga eksperti nuk është marrë në konsideratë nga ky Këshill. Sikundër konstatohet në arsyetim është cituar në mënyrë mekanike konkluzionet e aktit të ekspertimit pa i dhënë atij vlerën e provës në harmoni me provat e tjera të marra në shqyrtim. Për sa më sipër ky fakt përbën shkelje të rëndë të procedurës me pasojë pavlefshmërinë e aktit.

Së pesti: Nga përmbajtja e nenit 233 të ligjit nr.115/2016, dhe vendimit nr 4, dt 11.03.2019 të KED-së, rezulton që Avokati i Popullit është një subjekt me të drejtë fjale në mbledhjen e zhvilluara me dyer të mbyllura të KED, në kuadër të parimit të transparencës të cilit KED i vendos në dispozicion relacionin dhe gjithë procedurën e ndjekur nga KED për çdo kandidat gjatë procedurës së verifikimit. Referuar vendimit nr 108, 109 datë. 02.08.2019, pikës 44, 70 dhe 71 “Për ndalimin e kandidimit tim për vendin vakant për gjyqtar në GJK” rezulton se: “*Avokatii Popullit ka marrë pjesë në mbledhjen e datës 02.08.2018, dhe ka konstatuar se pas relativitetit të relatorëve dhe pyetjeve që iu janë bërë relatorëve ka mbetur e pa qartë problematika e paraqitur nga gjetjet e ILDKPKI në raport kjo me përfundimet e arritura nga eksperti duke kërkuar thirrjen e tij përpara KED, me qëllim që të dëgjohej dhe ti bëheshin pyetje. Avokati i Popullit ka çmuar që për disa çështje në rastin konkret ka pasur nevojë për një hetim të mëtejshëm të çështjes*”. Për sa më sipër arrijmë në konkluzionin se relacioni nuk ka një analizë të qartë dhe të kuptueshme për kriterin e pasurisë. Si kundër konstatohet edhe nga vendimi i arsytuar provat e dërguara rishtas nga paditësja nuk kanë gjetur pasqyrim në relacion, nuk kanë marrë vëmendjen e duhur në debatin e bërë në mbledhjen e datës 02.08.2019 për pasojë nuk kanë gjetur pasqyrim as në vendimin përfundimtar. Në analizë për sa më sipër vendimet janë absolutisht të pavlefshme pasi janë marrë në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji dhe aktet nënligjore.

Së gjashti: Vendimi objekt shqyrtimi përmban të dhëna të pa vërteta.

Në pikën 39 të vendimit nr.108 datë 02.08.2019, i padituri KED arsyeton:

Në zbatim të pikës 34 të vendimit të KED Nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për Procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në gjykatën kushtetuese dhe të inspektorit të lartë të drejtësisë*”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori i është njoftuar kandidatës Zhaklina Peto.

Ky fakt i pasqyruar si rrethana fakti dhe procedurës që do të duhej të ndiqte KED në procesin e verifikimit është i pa vërtetë. Ky fakt është tërësisht i pa vërtetë dhe në mohim të së drejtës së informimit të përfundimit të procesit administrativ, në kundërshtim me parimin e barazisë në këtë proces në lidhje me kandidatët e tjerë, sikundër provohet nga komunikimi nëpërmjet postës elektronike (e-mail) me të paditurin KED.

Komunikimi për ditën kohën dhe zhvillimin e mbledhjes së bashku me relacionin nuk më janë komunikuar në asnjë nga mënyrat e komunikimit që njeh ligji.

Referuar rrethanave dhe faktit rezulton që i padituri KED, jo vetëm që nuk i ka përmbushur detyrimet ligjore proceduriale në drejtim të paditëses Zhaklina Peto por edhe i pasqyron ato si fakte të vërteta në vendimin përfundimtar. Kjo përbën një shkelje të rëndë të procedurës të ndjekur nga i padituri KED i cili jo vetëm që nuk më ka njoftuar sipas germës B pika 34 Kreu III “*Fazat e procedurës administrative të verifikimit të kandidatëve*” i Vendimit Nr. 4, datë 11.03.2019, por në

mënyrë të qëllimshme për të fshehur të vërtetën e pasqyron në arsyetimin e vendimit në pikën 39 të tij sikur e ka përmbushur këtë detyrim.

Mjafton ky evidentim nga ana e kësaj Gjykatë që ta shpallë të pa vlefshëm vendimin nr 108, 109 datë 02.08.2019. Për faktin se në vendimin e arsyetuar duhet të pasqyrohen në mënyrë të qartë dhe të saktë procedura administrative e ndjekur e cila i paraprin aktit përfundimtar.

Në konkluzion të sa më sipër, i padituri ka pasqyruar rrethana të pa vërteta në vendimin objekt ankimi çka e bëjnë atë të cënueshëm me pasojë pavlefshmërinë e tij.

Pala e paditur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kërkoi rrëzimin e padisë duke prapësuar se:

-Me anë të padisë, pala paditëse/ankuese Zhaklina Peto parashton katër pretendime dhe argumente ligjore, mbi bazën e të cilave i kërkon gjykatës shfuqizimin e vendimit nr.108, dhe nr. 109 datë 02.08.2019.

-Në lidhje me argumentin e parë ku mbështetet padia, që lidhet me mosnjohimin e paditëses për ditën dhe orën e zhvillimit të mbledhjes, mosnjohje me relacionin e përgatitur nga relatori në përfundim të hetimit administrativ që ai ka kryer për shqyrtimin e kriterëve ligjore, profesionale dhe morale, duke e cilësuar shkelje tepër të rëndë, vlerësojmë se nuk gjen mbështetje në fakt dhe në ligj.

Neni 228 pika 5 të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, sanksionon në mënyrë taksative, se cilat janë detyrat e relatorit dhe konkretisht:

“... Për zhvillimin e procedurës së verifikimit, vlerësimit dhe renditjes, relatori kryen detyrat e mëposhtme:

a) shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit të depozituar nga kandidatët;

b) kërkon kontrollin e pasurisë së kandidatëve dhe verifikimin e rekordeve penale dhe disiplinore të tyre;

c) përgatitjen e projektaktit të verifikimit, vlerësimit dhe të renditjes së kandidatëve;

ç) koordinimin me kryetarin për përgatitjen e mbledhjes së Këshillit;

d) përgatitjen e komunikatës për mediat;

dh) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj”.

Mbi bazën e përcaktimeve të ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, është miratuar edhe akti normativ vendimi nr.4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në të cilin janë parashikuar një sërë të drejtash dhe garancish për kandidatët në kuadër të transparencës dhe përzgjedhjes së kandidatëve më të mirë të mundshëm për gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese.

-Në asnjë moment, qoftë relatori i çështjes apo anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, nuk kanë vepruar në kundërshtim me ligjin, çdo veprim që kanë kryer ka qenë në përputhje të plotë me qëllimin që u ka vendosur ligji, si dhe duhet theksuar se ka qenë një nga organet kushtetuese më transparente dhe më bashkëpunuese.

Pala paditëse, pretendon se nuk është njoftuar për zhvillimin e mbledhjes së datës 02.08.2019, ky është një fakt dhe pretendim i pavërtetë, pasi me emailin e datës 01.08.2019 paditësja është

njoftuar duke i dërguar edhe akt-ekspertimin përkatës, si dhe i është kërkuar opinion brenda ditës, pasi ditën e nesërme, pra në datë 02.08.2019 do të shqyrtohet edhe kandidatura e saj.

Gjithashtu nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është bërë edhe njoftimi përkatës për median, në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, se në datën 02.08.2019 do shqyrtohen edhe gjetjet e deritanishme për kandidaten Zhaklina Peto. Këto fakte rrëzojnë pretendimin e palës paditëse se nuk është njoftuar dhe se është shkelur procedura, duke i shkelur të drejtat e pretenduara.

Përsa i përket pretendimit se është shkelur rëndë procedura duke mos i dërguar relacionin me gjetjet, është i pa mbështetur në fakt edhe në ligj, pasi bie ndesh me nenin 238 të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i cili e ka përcaktuar qartë dhe në mënyrë taksative se ndaj vendimeve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, mund të bëhet ankim vetëm për shkelje të rënda procedurale.

-Në asnjë moment paditësja nuk arsyeton konkretisht se cilat norma juridike të së drejtës pozitive janë shkelur nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Kjo merr më shumë rëndësi në kushtet kur kjo mosmarrëveshje dhe ky gjykim ka për objekt vetëm çështje të së drejtës procedurale të respektuar ose jo nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Të pretendosh një shkelje apo një mënyrë të ndryshme të interpretimit të ligjit nuk do të thotë apriori apo edhe nëpërmjet interpretimeve të sforcuara, se kemi të bëjmë me shkelje procedurale dhe akoma më keq shkelje të rënda procedurale.

Duke i'u referuar nenit 238 të ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, ndaj vendimeve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, mund të bëhet ankim vetëm për shkelje të rënda procedurale, kupton qartë se shkelja e kryer nga organi publik, duhet të jetë në atë shkallë sa i gjithë procesi të bëhet nul. Pra, nuk mund të pretendosh se është interpretuar ndryshe ligji dhe të jemi përpara pavlefshmërisë absolute.

Në lidhje me pretendimin e palës paditëse se i është mohuar mundësia të njihet me përfundimet në relacion dhe që të paraqiste pretendimet të tjera, sqarojmë se në relacion pasqyrohet në mënyrë kronologjike e gjithë procedura e ndjekur nga ana e relatorit apo Këshillit. Ky relacion i palës së paditur nuk përban asgjë të re dhe të ndryshme nga ajo që pala paditëse është në dijeni, pasi ka dhënë shpjegimet përkatëse. Në këto kushte njohja me këtë relacion ose jo nuk do të ndryshonte asgjë në raport me këtë kandidate, pasi ajo ishte në dijeni të faktit të kësaj gjetje.

Relacioni, ashtu sikundër mund të konstatohet dhe vlerësohet edhe nga ky Kolegj, nuk përmban gjetje apo probleme për të cilat pala paditëse nuk është në dijeni, por përkundrazi në relacion është trajtuar çështja në mënyrë korrekte dhe transparente. Ky relacion është një veprimtari rutin që ndjek këshilli me qëllim njohjen e kandidatëve me gjendjen e faktit dhe ligjit dhe nuk ka të bëjë me faktin dhe qëllimin e njoftimit për efekt mbrojtjeje nga ana e kandidatëve apo të presë prapësime, pasi procedura është mbyllur dhe Këshilli është në fazë e vendimarrjes për lejim ose jo të kandidimit.

Vlen të theksohet se ky relacion nuk përmban në asnjë moment konkluzione apo vlerësime të shprehura ose jo nga ana e relatorit, por siç u citua edhe më lart pasqyrohet në mënyrë kronologjike e gjithë procedura e ndjekur për secilin kandidat. Ky relacion ka efekte vetëm njohje dhe nuk ka të bëjë me procedurën dhe vendimarrjen, pasi siç ka ndodhur në disa raste të tjera ky relacion është dërguar edhe ditën e mbledhjes.

Pala paditës pretendon se i është mohuar e drejta për tu shprehur në lidhje me gjetjet faktet dhe provat, e drejta për tu informuar, parimi i transparencës, parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, parimi i drejtësisë dhe i paanësisë, parimi i objektiviteti.

Ky fakt jo vetëm është i pavërtetë, por vlen të theksohet se palës paditëse i janë njohur të gjitha garancitë që përcakton ligji dhe aktet nënligjore.

- *Së pari*, vlen të theksohet se palës paditëse i është njohur e drejta të paraqitet në një kohë të mëvonshme nga ajo e përcaktuar nga ana e Këshillit, pasi duhet theksuar se afati për tu paraqitur pranë KED për marrjen në dorëzim të formularëve dhe autorizimeve ka qenë në datë 10.04.2019, ndërkohë nga ana e këshillit i është shtyrë ky afat deri në datë 15.04.2019, pas kërkesës së saj për shtyrje.

- *Së dyti*, palës paditëse i është caktuar ekspert kontabël, nga këshilli duke i dhënë asaj më shumë garanci me të vetmin qëllim sqarimin e paqartësive të konstatuara nga ILDKPKI në raport me shpjegimet e palës paditëse.

- *Së treti* dhe më thelbësorja në gjithë këtë proces është pretendimi se nuk i është njohur mundësia për tu njohur dhe për tu shprehur në lidhje me gjetjet. Ky pretendim është tërësisht i pavërtetë pasi në datë 30.05.2019 paditësja është njoftuar për gjetjet e konstatuara nga ILDKPKI, duke i kërkuar dhënien e shpjegimeve dhe paraqitjen e dokumentacionit justifikues.

-Pas këtij njoftimi paditësja (kandidatja) Zhaklina Peto, me shkresën e datës 06.06.2019, nr. 380 prot të Këshillit, ka dhënë shpjegimet përkatëse dhe ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues, në lidhje me gjetjet e sipërcituara.

- Në vijim nga ana e këshillit është konkluduar se ka vend për thirrjen e një eksperti kontabël për sqarimin e disa situatave të paqarta dhe kjo është një kompetencë ekskluzive e këtij këshilli dhe nuk ka nevojë të marrë mendimin e kandidates. Në respektim të të drejtave të saj, Këshilli e ka njoftuar paditësen me email-in e datës 25.07.2019, nëse ka apo jo konflikt interesi me ekspertin e caktuar.

-Nga ana e saj paditësja, në po të njëjtën datë, ka shprehur shprehur qëndrimin për këtë njoftim dhe ka deklaruar se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit dhe nuk ka shkaqe papajtueshmërie.

-Gjithashtu nga ana e këshillit në datë 01.08.2019 është njoftuar pala paditëse në lidhje me përfundimet e arritura nga ana e ekspertit, duke i vendosur në dispozicion akt-espektimin dhe i është kërkuar opinionin nëse ka. Nga ana e saj paditësja, po në të njëjtën datë 01.08.2019, ka deklaruar se akti i ekspertimit është i qartë, i saktë dhe i vërtetë, si dhe nuk ka komente në lidhje me përmbatjen e tij.

-Duke i'u referuar shpjegimeve për sa më sipër, vlerësojmë se pretendimet e ngritura nga pala paditëse se është diskriminuar apo këshilli të ketë shfaqur anshmëri, ti jetë mohuar e drejta për tu njohur me gjetjet e për tu shprehur në lidhje me to, nuk janë të bazuara.

- *Në lidhje me argumentin e dytë* Po ti referohemi këtij vendimi objekt gjykimi nga pika 52 e tij dhe deri në pikën 72 është arsyetuar dhe sqaruar në mënyrë shteruese vendimmarrja e këshillit për ndalimin e kandidimit të palës paditëse, si dhe iu ka dhënë përgjigje edhe pretendimeve që janë ngritur në këtë padi nga palë paditëse, duke arsyetuar qartë faktet, rrethanat dhe provat.

Nuk mund të pretendohet se kemi shkelje të rënda procedurale për mosarsyetim, vetëm se arsyetimi ezaurues i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në vendimin objekt gjykimi është i kundërt me interesat apo pritshmëritë e palës paditëse.

- **Në lidhje me argumentin e tretë** *Së pari* pala paditëse duhet të qartësojë se cila dispozitë ligjore është shkelur nga ana e Këshillit dhe se cilat të drejta i janë shkelur, përse kohë akt-ekspertimi është kryer për të sqaruar problematikat apo gjetjet e konstatuara nga ILDKPI në raport me shpjegimet e dhëna nga kandidatja paditësja Zh.Peto.

Së dyti, pala paditëse konfondon Këshillin e Emërimeve në Drejtësi me gjykatat, pasi në rastin konkret nuk jemi në procedura gjyqësore, por jemi përpara një procedure administrative dhe është diskrecion vetëm i këtij organi të ndërmarrë të gjitha ato veprime që ai i çmon të arsyeshme për sqarimin e të gjithave rrethanave të paqarta dhe interpretimin e provave dhe vlerën që ajo u jep atyre në raport me njëra tjetrën.

Së treti, paditësja e konsideron caktimin e ekspertit shkelje të rëndë procedurale, por nuk shpjegon se si ka ndikuar kjo në vendimmarrjen e këshillit, pasi e ritheksojmë akt-ekspertimi është kryer për të sqaruar problematikat apo gjetjet e konstatuara nga ILDKPI në raport me shpjegimet e dhëna nga kandidatja paditësja Zh.Peto për të cilat nevojitej një opinion i specializuar.

- **Në lidhje me argumentin e katërt** është diskrecion i Këshillit interpretimi i fakteve, rrethanave, pretendimeve dhe provave, si dhe vlerën që ajo u jep atyre në raport me njëra tjetrën. Kjo e sqaruar në vendimin objekt gjykimi në pikën 70 - 71 të tij, duke sqaruar në mënyrë shteruese këtë pretendim.

-Një tjetër moment që vlen për tu evidentuar ka të bëjë kërkimin e dytë të palës paditëse për lejimin e kandidimit nga gjykata, i cili është një kërkim tërësisht i pabazuar në ligj.

- Nuk mund ti kërkosh gjykatës të të lejojë për të vijuar me procesin e vlerësimit, pasi është atribut kushtetues dhe është një tagër eksplicit i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Gjithsesi kjo pikë nuk duhet marrë në shqyrtim nga gjykata, pasi nuk ka të bëjë me shkeljet e rënda procedurale që janë objekt shqyrtimi prej saj, në kuptim të nenit 238 të ligjit nr.115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë".

Personi i tretë Avokati i Popullit kërkoi pranimin e kërkesë padisë për pikën e parë dhe rrëzimin e padisë për pikën e dytë, duke parashtruar se:

-Në rastin konkret procedura në vetvete i caktimit të një eksperti është gjë e mirë në gjykimin tonë sepse nëse do të ketë një ndryshim të gjetjeve të ILDKPKI -së, këto duhet të jenë të arsyetuara, nëse ndryshon qëndrimi i KED-së ndaj pretendimeve të ILDKPKI -së duhet në mënyrë të arsyetuar të ishin gjetur se për çfarë arsye këto gjetje të ILDKPKI -së nuk përbënin shkak për ndalimin e kandidimit në rastin konkret. Për këtë arsye në momentin kur është vendosur nga ana e Këshillit që do të caktojë ekspert në rastin konkret është bërë një diskutim në Këshill, nga ana Avokatit të Popullit apo dhe nga anëtarët e tjerë dhe është pyetur se cilat janë gjetjet për të cilat do të caktohet ekspert, pra pse ka lindur nevoja për caktimin e ekspertit.

Në datën në të cilën është caktuar eksperti, është trajtuar pikërisht kjo çështje pasi kjo lidhet me përfundimin e gjyqimit, nga ana e anëtarëve u diskutua se cilat janë gjetjet konkrete për të cilat duhet të caktohet eksperti, pasi nuk kishte ardhur akoma relacioni, dhe gjatë hetimit lindi nevoja që të caktohej një ekspert për cilat gjetje ka nevojë për ekspert, dhe ishin relatorët të cilët me një vendim të përbashkët caktuan pyetjet që duhet t'i drejtoheshin ekspertit.

-Mendoj që të gjitha pyetjet që kishin pasur në mënyrë shteruese relatorët do të duhet të ishin trajtuar në aktin e ekspertimit pra, këta relatore çfarëdo lloj pyetje që kishin pasur në lidhje me këto gjetjet duhet ti kishin identifikuar, të sillnin një ose më shumë ekspert, dhe të jepnin dhe gjetjet përkatëse që të verifikoheshin çështjet nga eksperti.

-Nga vendimi i KED-së vërejtëm se shkaqet që është ndaluar kandidimi nuk ishin ato për të cilat ata kishin marrë ekspert. Pergjigjia që del nga këshilli në vendimmarrje është që neve nuk ka nevojë të thërrasim ekspertin se shkaqet për të cilat po ndalojmë kandidimin nuk janë ato që ka sqaruar eksperti. Lind pyetja, përse është thirrur eksperti kur nuk ka pasur nevojë për ekspertim dhe ka pasur shkaqe drejtpërdrejtë të ndalimit.

-Gjatë gjithë hetimit u kuptua se ato problematika që kishte pasur i kishin bërë pyetje dhe ishin trajtuar nga ana e ekspertit.

-Në momentin që u paraqit akti i ekspertimit dhe relacioni në lidhje me këtë çështje kemi ngritur pretendimin tonë se struktura e relacionit është totalisht e paqartë, nuk përmbledh rezultat e hetimit, nuk kishte një përfundim, pra në një mënyrë ose në një tjetër relatori duhet të paraqesë argumentat pro apo kundër në lidhje me të gjitha problematikat. Pretedimet i kemi dërguar me shkrim në Këshill dhe në rastin konkret kemi qenë të paqartë për të dhënë një mendim përfundimtar dhe për këtë shkak kemi kërkuar edhe pyetjen e ekspertit në këshill.

-Standartet e procesit gjyqësor janë të ndryshëm nga ai administrativ që rregullohen nga ligje të ndryshme dhe sigurisht duhet të ruajnë disa karakteristika që kanë të bëjnë me procesin e rregullt ligjor. Thënë kjo si parantezë dalin problematika dhe gjetje konkrete që kishin të bënin me aktin e ekspertimit. Në relacionin që paraqiti relatori dhe në diskutimet që u bënë në mbledhje dolën disa probleme, pyetje që secili prej anëtarëve kishin në lidhje me gjetjet e ILDKPKI -së pasi kishin marrë, lexuar gjetjet e ILDKPKI -së, kishin lexuar qëndrimet e kandidatit dhe pasi kishin parë raportin e ekspertit, për të tëra pyetjet që u bënë kishin përgjigje pozitive, përgjigje që kundërshtonin përfundimet e ILDKPKI-së, që të çonin në lejimin e kandidimit.

-Pyetje të tjera, ishte, mbi bazën e cilave dokumenta dhe çfarë kishte marrë në konsideratë dhe deri ku ishte hetuar çështja, kjo për hir të së vërtetës dhe pikërisht për këtë fakt duke qenë se relatorët nuk arritën të jepnin përgjigje shteruese të këtyre pyetjeve që unë kisha sygjeruar në përfundim të kësaj procedure që të vazhdonte hetimi në lidhje me këtë çështje në mënyrë që të thirrej eksperti për tu sqaruar këto problematika që kishin çuar në nevojën për të thirrur ekspert dhe në ballafaqimin e gjetjeve të aktit të ekspertimit. Psh. në lidhje me apartamentin e blerjes nga znj.Peto në lidhje me vlerën e këtij apartamenti gjetja e ILDKPKI -së ishte se vlera është shumë e ulët,

ndërsa eksperti thotë se është brenda referencës së kohës, kishte dhe paqartësi në lidhje me mënyrën e llogaritjes së ekspertit, metra në total apo ato të regjistruar sipas titullit të pronësisë, ndaj ishte nevoja për paraqitjen e ekspertit në mbledhjen e këshillit.

-Ne kemi patur qëndrime me shkrim lidhur me strukturën e relacionit dhe themi që struktura e relacionit nuk është në përputhje me atë që ka parashikuar apo ka pasur për qëllim, KED duke e mbyllur procesin edhe më tej, ky proces është mbyllur aq shumë pasi nuk kemi publikimin e procesverbaleve, procesi nuk është i hapur për publikun por edhe për ata persona që ligji parashikon që duhet të marrin pjesë që duhet të kenë dijeni për procesin për zbatimin e parimit të transparencës edhe për ata ka qënë i mbyllur për një pjese të caktuar. Për mendimin tonë vendimi është i parasyetuar.

-Përgatitja e mbledhjeve është kompetencë e Kryetarit të KED-së i cili së bashku me relatorin bëjnë veprimet që duhen proceduar për ta sjellë çështjen para Këshillit. Nuk ka asnjë parashikim që kjo është një detyrë e deleguar pasi kjo detyrë është lënë nga ligji (*relatori me Kryetarin koordinojnë përgatitjen e mbledhjes*) dhe kjo është një nga veprimet dhe verifikuar prej tyre. Pra jo vetëm relacioni nuk mban një qëndrim për ti bërë të mundur kandidatit që të japë qëndrimet përfundimtare para Këshillit pasi as edhe asnjë nga anëtarët e tjerë nuk e di çfarë ka ndodhur me kandidatin dhe të dilnin me një konkluzion konkret.

-Mosdërgimi i relacionit përbën shkelje të rëndë procedurale në lidhje me këtë çështje, gjithashtu dhe moszhvillimi i hetimit të plotë në lidhje me aktin ekspertimit përbën shkelje të rëndë procedurale dhe ne nuk kemi qënë në gjëndje për ndonjë qëndrim të qartë. Për këtë arsye, mendojmë se duhet një zhvillim i mëtejshëm i hetimit në lidhje me këtë çështje ndërsa në lidhje me lejimin e kandidimit mendoj se nuk është kompetencë e kësaj gjykate, por vendimi që do te lejojë apo jo kandidimin, i përket vetëm KED-së.

Personi i tretë Presidenti i Republikës së Shqipërisë kërkoi Pranimin e padisë për pikën e parë të objektit të padisë, sa i takon “Lejimit të kandidimit” në çmim të Gjykatës, duke parashtruar:

-Mosdërgimi i relacionit përbën shkelje të rëndë procedurale. Konstatojmë se ka dy standarte të KED-it, në një gjykim të mëparshëm (*të një kandidati tjetër*) u pranua që është njoftuar relacioni ndërsa në rastin objekt shqyrtimi nuk është njoftuar.

-Vendimet janë marrë rrjedhojë e një shkelje procedurale të rëndë dhe për këto arsye keto vendime duhet të shfuqizohen.

Vlerësimi i kolegjit administrativ

Kolegji Administrativ pasi shqyrtoi çështjen, dëgjoi palët, analizoi rrethanat, faktet dhe ligjin çmon se padia duhet të pranohet pjesërisht me arsyetimin si më poshtë vijon:

Së pari: Gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7/a, nenit 10/2/b të Ligjit Nr. 49/2012, në lidhje me nenin 238 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, kjo gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

Neni 7/a dhe 10/2/b i ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” parashikojnë:

Neni 7

Kompetenca lëndore

Gjykatat administrative janë kompetente për:

a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik;

Neni 10

2. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton:

a) ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë;

b) në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj.

Neni 238 i Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, parashikon:

*“Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit **vetëm për shkelje të rënda procedurale** bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë”.*

Objekt gjykimi janë vendimet nr. 108, datë 02.08.2019, dhe nr. 109 datë 02.08.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për ndalimin e kandidimit të kandidatës Zhaklina Peto, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallura nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, për të cilat në bazë të nenit 238 të ligjit nr.115/2016 kompetente për gjykimin e tyre është Gjykata Administrative e Apelit.

Së dyti: Në lidhje me afatin e kundërshtimit të vendimeve objekt shqyrtimi gjyqësor, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se paditësja është brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 238 i ligjit 115/2016 sipas të cilit: “Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për

ndalimin e kandidimit vetëm për shkelle të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar”. Përveç detyrimit që gjykata ka të verifikojë kushtet formale të padisë, ku hyn edhe respektimi i afatit të ngritjes së padisë, nga palët në proces në lidhje me afatin nuk pati pretendime për mos respektim të tij.

Së treti: në lidhje me personat e tretë në gjykim, ligji nr. 115/2016 ka parashikuar në nenin 223 në zbatim të parimit të transparencës se:

“1. Mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë të mbyllura. Avokati i Popullit merr pjesë në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit.

2. Përfaqësues të autorizuar të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe 2 anëtarë të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, njëri prej të cilëve i përket opozitës, ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit”.

Personi tretë në gjykim Avokati i Popullit shpjegoi se në zbatim të ligjit ai njihet nga Këshilli me aktet dhe relacionin e çështjes të hartuar nga relatori, merr pjesë në mbledhjet dhe ka të drejtën e fjalës.

Ndërsa personi i tretë Presidenti i Republikës shpjegoi se ai njoftohet për ditën dhe orën e mbledhjes dhe relacionin e hartuar nga relatori për kandidatin përkatës dhe është me cilësinë e dëgjuesit në mbledhjen e realizuar nga këshilli.

Në rastin objekt gjykimi detyrimi ligjor sikundër u pohua edhe nga palët në proces është realizuar nga i padituri.

Së katërti: Lidhur me pretendimet e ngritura në padinë e palës paditëse, Gjykata Administrative e Apelit çmon se, paditësja ka ngritur pretendime për pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ. Në këtë kontekst gjykata çmon të ndalet në radhë të parë në natyrën e këtij gjykimi dhe hapësirën që ligji i ka lënë gjykatës në këto lloj gjykimesh.

Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

*5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. **Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.**”*

Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, është parashikuar procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Në këtë kuadër paditësja ka paraqitur kandidaturën për të qenë pjesë e saj nga radhët jo magjistrat. Ky ligj dhe aktet nënligjore kanë parashikuar procedurën që duhet të ndiqet për tu bërë anëtar i Gjykatës Kushtetuese, kushtet që duhet të plotësojë kandidati, organin që vendos për ndalimin, si dhe gjykatën ku mund të paraqitet ankimi.

Neni 234 parashikon:

1. Presidenti i Republikës i dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e plotë të kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat plotësohen nga Presidenti i Republikës, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, menjëherë pas publikimit të listës së kandidatëve në faqen zyrtare të Presidentit.

2. Kryetari i Kuvendit i dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e plotë të kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat plotësohen nga Kuvendi, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, menjëherë pas publikimit të listës së kandidatëve në faqen zyrtare të Kuvendit.

Neni 235 parashikon:

1. Menjëherë pas dërgimit të listave me emrat e kandidatëve ose të paraqitjes së shprehjes së interesit nga kandidatët, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i pajis kandidatët me formularët për deklarinimin e pasurive dhe të interesave financiarë.

2. Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularëve për deklarimin e pasurive dhe të interesave financiarë, kandidatët i dorëzojnë ato të plotësuara pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili kryen kontrollin e saktësisë dhe të vërtetësisë së deklarimit brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij.

3. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave i dërgon menjëherë Këshillit rezultatet e kontrollit.

4. **Me përfundimin e procedurës së deklarimit dhe kontrollit të pasurisë, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatit e verifikimit, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit. Urdhri për ndalimin e kandidimit është gjithnjë i arsyetuar**

Neni 238 parashikon:

Ankimet kundër vendimeve për ndalimin e kandidimit

1. Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar.

2. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.

3. Ankimi nuk pezullon zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe të verifikimit paraprak të kryer nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas nenit 240 të këtij ligji.

Në bazë të pikës 2 të nenit 229 i padituri KED ka nxjerrë vendimin nr.4, dt.11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë”, mbi të cilin është bazuar në veprimtarinë e tij administrative në shqyrtimin e aplikimeve të paditëses Zhaklina Peto, për pasojë edhe ky vendim është pjesë e akteve nënligjore mbi të cilat ky kolegji bazohet në shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi.

Paditesja Zhaklina Peto është një ndër personat që ka shprehur interes për të kandiduar për plotesimin e vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë (për dy vakanca), procedura e kandidimit të të cilës rezulton të jetë ndërprerë me aktet objekt gjykimi, për të njëjtin shkak, për kriterin e pasurisë.

Pra duke iu referuar këtyre dispozitave Gjykata konstaton veçantitë e këtyre lloj gjykimesh dhe konkretisht:

Së pari: Në gjykatë paditesja mund të ngrejë padi vetëm për çështje që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, madje jo për çdo shkak që sjell pavlefshmërinë absolute, por vetëm me shkakun e parashikuar nga neni 108/1/a pika “ii” të K.Pr.Administrative, pra vetëm për shkelje të rënda të procedurës së organit vendimarrës dhe për asnjë shkak tjetër të pavlefshmërisë absolute.

Së dyti: Ligji nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ka kufizuar hapësirën e gjykimit gjykatës, vetëm për një nga rastet e pavlefshmërisë absolute duke i hequr asaj mundësinë të marrë në shqyrtim çështje të tjera që paditësi mund të ketë pretendim, për pavlefshmërinë absolute. Po kështu ky ligj i ka hequr mundësinë gjykatës të marrë në shqyrtim çështje që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë relative të aktit.

Pala paditëse pretendoi në këtë proces se, ka kërkuar nga pala e paditur ti vihet në dispozicion një kopje e akteve, relacioni si dhe proces verbali i mbledhjes së datë 02.08.2019, por nga pala e paditur nuk i janë dhënë këto akte.

Pala e paditur KED në gjykim paraqiti aktet shkresore që kanë të bëjnë me veprimtarinë administrative të ndjekur për shqyrtimin e aplikimeve të palës paditëse Zhaklina Peto, përfshi këtu edhe relacionet e hartuara nga relatorët Arta Marku dhe Eriol Roshi, nga përmbatja e tyre konstatohet fakti se nuk ka një mendim të propozuar nga relatorët e çështjes mbi lejimin ose ndalimin e kandidimit të paditëses, fakt i cili u pohua edhe nga palët në proces, ndërsa proces verbali i mbledhjes së datës 02.08.2019, nuk u paraqit nga pala e paditur në këtë gjykim.

Kolegji konstaton se gërma Ç. *Publikimi i akteve të procedurës së verifikimit. Komunikata për median,* i vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë”, në pikën 56 të tij parashikon: *“Në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi publikohen edhe :*

- a) lista e kandidatëve për të cilët është vendosur ndalimi i kandidimit;*
- b) lista e kandidatëve për të cilët është vendosur lejimi i kandidimit;*
- c) përmbledhje e procesverbalit të nënshkruar nga të gjithë anëtarët që kanë marrë pjesë në mbledhjen ku vendoset lejimi ose ndalimi i kandidimit;*
- ç) komunikata për median sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 233 të ligjit nr. 115/2016.*

Nga aktet e administruara në gjykim, shpjegimet e palëve në proces rezultoi e provuar se në përfundim të mbledhjes së datës 02.08.2019, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi rezulton se ka marrë: vendimin nr. 108, datë 02.08.2019, me të cilin ka vendosur: *“Ndalimin e kandidimit të kandidates Zhaklina Peto, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018”;* vendimin nr. 109, datë 02.08.2019, me të cilin ka vendosur: *“Ndalimin e kandidimit të kandidates Zhaklina Peto, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018”.*

Sipas pikës 77 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë” ndalimi i kandidimit vendoset në rastet kur ka të dhëna nga burime të ligjshme se kandidati:

- a) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- b) ka fshehur pasurinë dhe të dhënat mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;*

- c) ka kryer deklarin të rremë;
ç) gjendet në situatën e konfliktit të interesit;

Të gjithë aktet administrative që kanë ndaluar kandidimin e paditëses Zhaklina Peto, kanë një shkak, atë të mos plotësimin të kushtit ligjor të përcaktuar nga shkronja “dh” e nenit 7/a të ligjit nr.8577/2000 dhe nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, që i përket kriterit të pasurisë duke arsyetuar se:

“58. Nga analiza e akteve, të dhënave dhe gjetjeve në procedurën e verifikimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konstaton se me të drejtë ILKPKI në raportin e saj ka arritur në përfundimet se deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, dhe se ka mungesë dokumentacioni si dhe ka mosdeklarime të pasurive dhe vlerave të tyre.

59. Kështu, në lidhje me apartamentin që deklaroi kandidatja të ndodhur në Rrugën “I. Q.” Tiranë me sipërfaqe 130 m², rezulton se kandidatja e ka blerë këtë apartament së bashku me të birin e mitur në atë kohë, shtetasi E.Ç. dhe bashkëshortin, shtetasin B.Ç., me kontratën (***)/(***), datë 17.03.2000 nga shtetasi i huaj A.L.S., kundrejt vlerës prej 3.900.000 lekë dhe me burim dhurim të hollash nga prindrit e kandidatës me kontratën nr. (***)/(***), datë 10.10.1999.

60. Mirëpo rezulton se edhe nga shpjegimet e kandidatës dhënë Këshillit, si dhe leja e legalizimit nr. (***), datë 02.11.2016, si dhe konstatimet e ILDKPKI –së, se kandidatja së bashku me apartamentin në fjalë, ka blerë efektivisht në vitin 2000 edhe një shtesë kati mbi apartamentin e blerë të përbërë nga 53.6 m² apartament dhe 64.9 m² verandë. Kjo shtesë kati në kohën e blerjes ka qenë pa leje të organit kompetent dhe është ndërtuar nga shitësi.

61. Por nga ana tjetër rezulton se ky ndërtim pa leje është përfituar me anë të lejes së legalizimit që tregohet më lart dhe se përfituesit e lejes së legalizimit janë kandidatja dhe shtetasit B.Ç. dhe E.Ç. .

62. Ky dokumentacion provon faktin se efektivisht edhe kandidatja ka blerë përveç 130 m² sipas kontratës që tregohet më lart kundrejt çmimit 3.900.000 lekë, edhe një sipërfaqe 130 m² e cila nuk rezulton të ketë një çmim në kontratë (shtesa e katit). Është e vërtetë që ky send në atë kohë, pra në kohën e lidhjes së kontratës, nuk kishte hyrë në qarkullimin civil por kandidatja e ka përfituar atë më pas në sajë të lejes së legalizimit dhe për rrjedhojë duhet të provonte çmimin e blerjes së tij dhe mandej edhe ta lidhte këtë çmim me burimin e ligjshëm.

63. Po kështu, rezulton se kandidatja me kontratën nr. (***)/(***), datë 30.10.2009 ka lidhur një kontratë për ndërtim apartamenti në Tiranë, në Rezidencën “K. e D.”, Rr. e J. C3, me ndërtues personin juridik “A.K.” SHPK kundrejt çmimit 96.750 euro dhe me sipërfaqe 110 m² me burim të ardhurash: Kontratë qeraje nr. (***)/(***) të viteve 2009, 2010, kontratë kredie bankare të datës 10.05.2010 në Raiffeisen Bank Sha në shumën 19.122.55 euro dhe kursimet personale të saj dhe bashkëjetuesit (bashkëshortit) shtetasit A.V. ndër vite.

64. Apartamenti në fjalë me anë të kontratës së kalimit të të drejtave të pronësisë nr. (***)/(***), datë 23.04.2015 i ka kaluar shtetasit B.B me pëlqimin e ndërtuesit dhe kandidates. Në këmbim kandidatja me pëlqimin e palëve që tregohen më lart , ka përfituar një apartament me sipërfaqe banimi 156.2 m² në objektin “Banesë 3 kate plus nënçati në S., Tiranë. Sqarohet se apartamenti që ka kandidatja ka këmbyer, ka qenë në kohën e kontratës së datës 30.10.2009 në kuotën +3.06 m². Në kontratë pranohet që palët i kanë shlyer personit juridik të gjithë çmimin që rrjedh nga kontratat përkatëse (përpara kalimit të të drejtave) dhe se ato kanë marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rridhnin nga kontratat e mëparshme.

65. Apartamenti i ri, është regjistruar në regjistrat publikë me numër 109/239/5-11, zona kadastrale 3292, vol. 56, fq 32 dhe i është shitur kandidates nga “A.K.” SHPK kundrejt vlerës 117.150 euro sipas kontratës (***)/(***), datë 23.02.2017.

66. Në vijim, me kontratën me kusht kreditimi nr. 2560/1555, datë 06.06.2018, apartamenti në fjalë është shitur nga kandidatja me pëlqimin e shtetasit A.V. blerëses B.D. kundrejt çmimit 170.000 euro, që do të paguheshin sipas kontratës 15 000 euro kapar (të likujduara në datë 16.05.2018 sipas kontratës respektive) dhe diferenca nëpërmjet kredisë së dhënë blerësit nga Societe General Albania (Bankë e nivelit të dytë).

67. Në lidhje me sa më lart, rezulton se kandidatja ka kryer rivlerësimin e kësaj pasurie sipas ligjit 81/2016 “Për rivlerësimin e pasurisë së paluajtshme” dhe nëpërmjet këtij veprimi ajo shpjegon diferencën në çmimin e blerjes dhe atë të shitjes. Por edhe ky fakt vërtetohet atë se çmimi i shitjes në datë 23.02.2017 nuk ka qenë 117.150 euro, përderisa është rivlerësuar për efekt të pagimit të tatimit. Këshilli mban parasysh faktin se kontrata e shitjes së datës 23.02.2017 është lidhur pas hyrjes në fuqi të ligjit 81/2016 dhe se efektet e këtij të fundit shtriheshin sipas nenit 5 të tij deri në datë 28.02.2017.

68. Po kështu, rezulton se në vitin 2013, kandidatja ka blerë një automjet Volkswagen Passat kundrejt shumës 500.000 lekë dhe e ka shitur atë në vitin 2017 në vlerën 13.000 euro. Ky fakt pranohet edhe nga kandidatja me shpjegimin se automjeti është blerë si okazion pasi pala shitëse kishte probleme të rënda financiare dhe se çmimi 13.000 euro i përgjigjet gjendjes së tij teknike fakt që vërtetohet me rishitjen e tij më pas në vitin 2019 në shumën 12.000 euro.

69. Në lidhje me këtë konstatim ose gjetje Këshilli çmon se më të drejtë ILDKPKI ka konstatuar një diferencë të shpërpjesëtuar mes çmimit të blerjes dhe atij të shitjes nga kandidatja. Kjo e fundit duhet të provonte se edhe pse çmimi i shitjes ka qenë okazion si edhe shprehet, ky rast nuk është bërë shkak për shmangien e detyrimeve tatimore.

70. Në lidhje me thelbin e qëndrimit të Avokatit të Popullit se “ndërkohë që Këshilli ka miratuar në datën 24.07.2019 ekspertin mbi propozimin e relatorëve (pika 19 e relacionit), kompetenca për caktimin e ekspertit është e Këshillit në kuadër të një gjetjeje të specifikuar duke përcaktuar po ky Këshill edhe pyetjet për ekspertin. Ky veprim ekspertimi është kryer vetëm për këtë candidate

ndërsa janë 11 kandidatë që kanë pasur raport negativ nga ILDKPKI, tregon për standard të ndryshëm nga KED. Pas pyetjeve që iu bënë relatorëve, jemi të mendimit se për të sqaruar tërësisht problematikat që ka paraqitur ILDKPKI në raportin e tij duhej që të thirrej e të dëgjohej eksperti për t'u përgjigjur pyetjeve përpara Këshillit. Edhe pas relatimit, gjykojmë se disa çështje kanë nevojë për hetim të mëtejshëm për të arritur në një konkluzion pozitiv për këtë kriter, të ndryshëm nga ai i ILDKPKI. Jemi të mendimit që konfirmimi i rezultateve të raportit të ekspertit nga ana e kandidatës është bërë në kuadër të prezumimit se ai ka qenë shterues", Këshilli çmon si më poshtë:

- Përgjigjet e ekspertit për Këshillin kanë qenë shteruese. Nga arsyetimi i Këshillit, si më sipër, ndalimi i kandidatës nuk vjen për shkak të të dhënave financiare dhe më këtë kemi parasysh burimin e veprimeve juridike, të konstatuara ndryshe nga ILDKPKI dhe ndryshe nga eksperti.
- **Përkundrazi i gjithë arsyetimi i Këshillit lidhet jo me burimin e të ardhurave në rastet që janë arsyetuar më lart, por në vetvete me faktet juridike që ato përfaqësojnë.**

71. Për këtë arsye, meqenëse ndalimi i kandidimit nuk lidhet me mospasjen e burimeve financiare të mjaftueshme, por me arsyet që tregohen më sipër në këtë vendim, Këshilli nuk vlerësoi të nevojshëm thirrjen dhe pyetjen në seancë të ekspertit për të sqaruar më tej çështje të lidhura me burimet financiare të mjaftueshme për krijimin e pasurive. Nga ana tjetër, për sa i takon marrjes ose jo të provës me eskeprt në rastet e kandidatëve të tjerë të shqyrtuar nga Këshilli, vetë Këshilli ka parasysh se çdo situatë fakti për kandidimet është individuale dhe për rrjedhojë nuk lidhet me rastet e tjera.

72. Pa qenë e nevojshme që të trajtohen dhe konkludohet mbi gjetjet e tjera të ILDKPKI dhe prapësimet e shpjegimet përkatëse të argumentuara hollësisht të kandidatës Zhaklina Peto lidhur me to, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se arsyetimi që parashtrohet në pikat 58-71 më sipër, mbi gjetjet në procedurën e verifikimit të pasurisë dhe ligjin e zbatueshëm lidhur me to, është i mjaftueshëm për të ardhur në përfundimin se kandidatja Zhaklina Peto gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për mospërmbushje të kushtit ligjor të parashikuar nga shkronja "dh" e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe neni 235 i Ligjit nr. 115/2016".

Kolegji administrativ i Gjykatës Administrative të Apelit vlerëson se nga pala e paditur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi janë lejuar shkelje të rënda të procedurës në nxjerrjen e akteve, vendimeve nr. 108 dhe 109 të datës 02.08.2019 të tilla që passjellin shfuqizimin e tyre, pasi kanë dalë në kundërshtim të hapur dhe flagrant me legjislacionin në fuqi në lidhje me procedurën e nxjerrjes së tyre.

Sipas vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë", parashikohet që:

37. Kryetari i Këshillit fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e procedurave, të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurave për verifikimin e përmbushjes së kushteve dhe kritereve të tjera ligjore nga kandidati i verifikuar.

38. Në përfundim të parashtrimeve të relatorit, nëse vlerësojnë, anëtarët e Këshillit mund ti drejtojnë pyetje dhe të kërkojnë shpjegime të natyrës sqaruese.

39. Pas anëtarëve të Këshillit, nëse e vlerëson, Avokati i Popullit mund të parashtojë mendime dhe vlerësime vetëm në lidhje me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit.

40. Nëse anëtarët e Këshillit nuk parashtrojnë pyetje dhe kërkesa të tjera sqaruese në drejtim të relatorit, Këshilli deklaron kalimin në fazën e bisedimit, votimit dhe të dhënies së vendimit.

41. Bisedimet e çështjes, si edhe votimi i vendimit bëhen vetëm me praninë e anëtarëve të Këshillit.

Nga shpjegimet e Avokatit të Popullit, por edhe nga përmbajtja e vendimit objekt ankimi rezulton se në shqyrtimin e kandidaturës së paditëses Zhaklina Peto në mbledhjen e Këshillit të datës 02.08.2019, është parashtruar relatimi nga anëtari relator dhe janë dhënë shpjegime mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, gjithashtu i padituri KED ka dëgjuar edhe mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidates Zhaklina Peto. Rezulton se, Avokati i Popullit ka pretenduar se, përtej qëndrimit të përgjithshëm të parashtruar në lidhje me njoftimet e materialeve për këtë procedurë, të bërë me dije me shkrim në komunikimin e mëparshëm e që janë të zbatueshme edhe në këtë rast, qëndrimi mbi rastin e procedurës së verifikimit të kësaj kandidateje është se, ndërkohë që Këshilli ka miratuar në datën 24.07.2019 ekspertin mbi propozimin e relatorëve (pika 19 e relacionit), kompetenca për caktimin e ekspertit është e Këshillit në kuadër të një gjetjeje të specifikuar duke përcaktuar po ky Këshill edhe pyetjet për ekspertin. Ky veprim ekspertimi është kryer vetëm për këtë kandidate ndërsa janë 11 kandidatë që kanë pasur raport negativ nga ILDKPKI, tregon për standard të ndryshëm nga KED. Pas pyetjeve që iu bënë relatorëve, jemi të mendimit se për të sqaruar tërësisht problematikat që ka paraqitur ILDKPI në raportin e tij duhej që të thirrej e të dëgjohej eksperti për t'u përgjigjur pyetjeve përpara Këshillit. Edhe pas relatimit, gjykojmë se disa çështje kanë nevojë për hetim të mëtejshëm për të arritur në një konkluzion pozitiv për këtë kriter, të ndryshëm nga ai i ILDKPI. Jemi të mendimit që konfirmimi i rezultateve të raportit të ekspertit nga ana e kandidates është bërë në kuadër të prezumimit se ai ka qenë shterues.

Kolegji kontaton se këtë qëndrim personi i tretë Avokati i Popullit e parashtroi në gjykim si një element të rëndësishëm të procedurës administrative të kryer nga i padituri, që në mendimin e tij ishte e nevojshme prania e ekspertit në mbledhje me qëllim dhënien e shpjegimeve të pyetjeve të shtruar për diskutim në rastin konkret, për sa kohë u kondisera në fazën e hetimit administrativ, e nevojshme nga ky këshill caktimi i një eksperti, ndërkohë që këshilli paska qenë i qartë në gjetjet

e tij, pasi në vendimin përfundimtar shkaqet e ndalimit ishin të ndryshme, nga ato për të cilat ka lindur nevoja e caktimit të një eksperti.

Kolegji vlerëson se në rastin konkret nga ana e palës së paditur KED ka shkelje të rregullave procedurale, të sanksionur nga vetë i padituri në Vendimin nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë”, në pikën 74 gërma A Kreu IV: “Procedura të veçanta për verifikimin e kandidatëve” i cili parashikon:

“Kur e vlerëson, Këshilli mund të thërrasë ekspertin për të dhënë shpjegime në mbledhjen e Këshillit. Në vendimin e arsyetuar të Këshillit për lejimin ose ndalimin e kandidimit trajtohet edhe nevoja për ekspertim dhe mendimi i dhënë nga eksperti”.

Në pikën 39 të vendimit nr. 108 dhe nr. 109 datë 02.08.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë”, i padituri KED arsyeton:

Në zbatim të pikës 34 të vendimit të KED Nr. 4, datë 11.03.2019 “Për Procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në gjykatën kushtetuese dhe të inspektorit të lartë të drejtësisë”, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori i është njoftuar kandidatës Zhaklina Peto.

Nga aktet në dosje, shpjegimet e palës paditëse dhe pohimet të palës së paditur rezultojnë se nga i padituri nuk është zbatuar detyrimi që rrjedh nga pika 34 e vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë”, i cili parashikon:

“34. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i njoftohet kandidatit të verifikuar dhe subjekteve që ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit sipas ligjit. Avokatit të Popullit i dërgohet edhe dokumentacioni i përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera prej tij gjatë procedurës së ndjekur për verifikimin e kandidatit. Ky njoftim bëhet publik edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi”.

Ndërsa pika 76 e vendimit parashikon:

“Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të ILDKPKI, atyre të nxjerra nga të dhënat që rezultojnë nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, si edhe nga shpjegimet me shkrim të dhëna nga kandidati, relatori vlerëson se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, procedon me përgatitjen relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit”.

Përfaqësuesi i palës së paditur pohoi në gjykim se relacioni nuk i është dërguar paditëses, ky fakt mund të ketë ndodhur nga ngarkesa e madhe.

Kolegji vlerëson se pretendimet e ngritura nga paditësja për mos njoftimin e ditës, kohën së zhvillimit të mbledhjes së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori u provuan në këtë gjykim.

Kolegji konstaton se pala e paditur nuk ka përmbushur detyrimin ligjor që rrjedh nga pika 34 e vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë”, duke e ndërprerë komunikimin me palën paditëse në lidhje me vijimin e shqyrtimit të kandidaturës së saj, në dërgimin e e-mail-it të fundit atë të datës 01.08.2019 që kishte të bënte me njoftimin e paditëses për përfundimin e aktit të ekspertimit të kryer nga eksperti i caktuar nga Këshilli në mbledhjen e tij të datës 24.07.2019.

Në datë 02.08.2019 i padituri ka zhvilluar mbledhjen e radhës dhe në përfundim ka marrë vendimet objekt ankimi për ndalimin e kandidimit të kandidatës Zhaklina Peto për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese për kriterin e pasurisë.

Mos komunikimi palës paditëse, të ditës, ores së zhvillimit të mbledhjes dhe bashkë me të i relacionit të hartuar nga relatorët përbëjnë shkelje të rëndë të procedurës së kryer nga i padituri, për pasojë aktet objekt gjykimi janë akte absolutisht të pavlefshme, të nxjerra në kundërshtim me procedurën e nxjerrjes së tyre me pasojë shfuqizimin e tyre.

Në lidhje me kërkimin e dytë, lejimin e kandidimit të paditëses për vakancën gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, pala paditëse rezulton se në seancën gjyqësore të datës, 20.08.2019 të zhvilluar me trupin tjetër gjykues ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi, kërkesë e cila nuk është marrë në shqyrtim pasi trupi gjykues ka vendosur me vendim të ndërmjetëm bashkimin e dy padive në një gjykim sikundër u citua më sipër në këtë vendim. Në gjykimin e kësaj çështje paditësja nuk e përsëriti këtë kërkim por në fjalën e fundit, për kërkimin e dytë të padisë pala paditëse në konkluzionet për fundimtare u shpreh se e lë në çmim të gjykatës zgjidhjen e çështjes.

Pavarësisht faktit se kjo palë e la në çmim të gjykatës disponimin mbi pikën e dytë të padisë, e cila është mjeti që vë në lëvizje gjykatën, ky kolegji vlerëson se kërkimi i parashtruar nga pala paditëse nuk është objekt gjykimi nga kjo gjykatë, pasi sikundër u citua më sipër në këtë vendim, Gjykata Administrative e Apelit investohet në këtë lloj gjykimesh me natyrë të veçantë si gjykatë e shkallës së parë, juridiksion fillestar, për shkak të ligjit nr. 115/2016, nenit 238, për vendimet e ndalimit të kandidimit, dhe vetëm për shkelje të rënda të procedurës. Në kushtet kur KED vepron si organ kolegjal, është në diskrecionin e tij të marrjes së vendimit lejimit të kandidimit të kandidatit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Për këtë shkak ky është një kërkim që nuk mund të parashtrohet

përpara kësaj gjykate për pasojë padia në lidhje me të duhet të pushohet si një kërkim që nuk mund të ngrihet në bazë të germës “c” të nenit 299 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të nenit 40/1/ a, të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, neni 238/1 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, të germës “c” të nenit 299 të Kodit të Procedurës Civile.

VENDOSI

- Pranimin pjesërisht të padisë.
 - Shfuqizimin e vendimin nr.108, datë 02.08.2019 të nxjerrë nga i padituri Këshilli i Emerimeve në Drejtësi .
 - Shfuqizimin e vendimit nr.109 datë 02.08.2019 të nxjerrë nga i padituri Këshilli i Emerimeve në Drejtësi .
 - Pushimin e gjykimin të çështjes për kërkimin e dytë të padisë.
 - Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.
 - Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
- U shpall më 22.08.2019 në Tiranë.**


GJYQTAR

BARI SHYFI



GJYQTAR

AMARILDO LACI



GJYQTARE

ALKELINA GAZIDEDJA

